

Janar 2000

- Më 22 Janar u zhvillua Asambleja e Jashtëzakonëshme e K.O.K.SH. it. Në këtë Asamble u aprovuan ndryshimet ne Statutin e K.O.K.SH-it te cilat i referohen ndryshimeve te ardhura nga CIO.

- Po ashtu u miratuan si anëtarë me të drejta të plota në Komitetin Ekzekutiv

- z. Hysen Domi dhe z. Genc Ruli.

- Gjithashtu ne kete Asamble u pranua anëtare edhe shoqata e Dancit Sportiv.

- Federata Shqiptare e Atletikes zhvilloi ne ambientet e Institutit te Larte te Kultures Fizike “Vojo Kushi” Kampionati Kombëtar në salla të mbyllura për femra dhe meshkuj. Ky Kampionat percaktoi edhe atletet candidate te cilet do te marrin pjese ne Kampionatin Ballkanik te sallave te mbyllura qe do te zhvillohet ne fillim te muajit te ardheshem ne Athine.

- Volejboll. U zhvillua Kupa e Republikës për meshkuj. Ne vend te pare dhe kupen perkatese e fitoi ekipi i Teutes se Durresit.

- Karate Federata Shqiptare e Arteve Marciale zhvilloi ne Tirane Kampionati Kombëtar Individual te Karatese.

-Federata Shqiptare e Basketbollit zhvilloi Turneun e parë Kombëtar te Minibasketit dhe Turneu i Bam - Pasarele

-Judo. Federata Shqiptare e Arteve Marciale morri pjese ne Turneu Ndërkombëtar te judos i cili u zhvillua ne Montekarlo.

Shkurt 2000

- Me date 11.02.2000. KAS morri ne shqyrtim kerkesen e Presidentit te Komitetit Olimpik Special z. Koço Gaba rreth problemit te emerimit te dy shoqatave me te njejtin emer. Komisioni pasi degjoi relatorin e çeshtjes z. A.Shyti vendosi pranimin e kerkeses se bere nga z. Koço Gaba.

- Me 18 Shkurt ne Pallatin e Kongreseve KOKSH-i ne bashkepunim me UNICEF organizuan Konferencen « Paqja dhe Sporti Feminor » Punimet e kesaj konference i pershendeten edhe zonja e pare Lidra Mejdani, zv. Kryeministria Makbule Çeço Presidenti i nderit te ABNOC z. Antonio Tzikas, arkitekti i CONI-it z. Enrico Carbone etj.

- Presidenti i KOKSH-it z. Arben Jorgoni morri pjese ne nje Konference Ballkanike te zhvilluar ne Shkup te Maqedonise ne te cilen u diskutua rreth problemeve shqetesuese te sportit ne ballkan.

- Fedarata Shqiptare e Atletikes organizoi ne ambientet e Klubit Sportiv « Dinamo » Kampionatin Kombetar te Krosit.ky aktivitet percaktoi edhe anetaret e ekipeve kombetare qe do te perfaqesojne vendin tone ne krosin Ballkanik.

- Mundje Federata Shqiptare e Mundjes me disa sportiste cilesore morri pjese ne Kajro te Egjyptit ne eliminoret e kualifikimit per ne Lojrat Olimpike te Sidney 2000.Ne kete aktivitet asnje nga sportistet tane nuk arriti te kualifikohej per ne Lojrat Olimpike te Sidney 2000.

- Federata Shqiptare e Volejbollit zhvilloi aktivitetin e Kupes se Republikes per femra. Ne perfundim te aktivitetit vendin e pare e morri ekipi i Teutes se Duresit.

Mars 2000

- Nga data 06-07 Mars u zhvillua ne Paris Konferenca e dyte Boterore «Femra dhe Sporti» Ne kete Konference morri pjese edhe Kryetarja e Komisionit «Femra dhe Sporti» Znj. Ela Tase. Ne themel te diskutimeve qendroi integrimi i femres ne te gjitha instancat e jetes shoqerore si dhe ne te gjitha pjeset perberese te sportit ne pergjithesi dhe komisineve te tij ne veçanti.

- Sekretari i Pergjithshem i KOKSH-it z. Stavri Bello me ftese te CIO-s zhvilloi nje specializim tre mujor ne fushen e Menaxhimit dhe Administrimit sportiv ne Universitetin e Lionit ne France.

- Nga data 29-Mars deri me 02 disa anetare te Komisionit te Sportit per te Gjithe morren pjese ne nje konference shtypi ne Rome te organizuar nga Unioni Italian i Sportit per te Gjithe. Ne kete Konference u diskutua rreth aktiviteve qe do te zhvilloi UISP-i ne te gjitha boten si dhe ne menyre te veçante rreth aktivitetit te «VIVIÇITA» qe do te zhvillohet ne vendin tone me 02-04 Qershor.

- Federata Shqiptare e Basketbollit ka zhvilluar ne javen e dyte te Marsit Turneun e ekipeve Bampasarele.

- Federata Shqiptare e Peshengritjes ka organizuar me 15 Mars Kupen e Republikes per te rritur.

- Shqiptare e Çiklizmit organizoi me 19-21 Mars Kupen «Gani Murriqi». Ne kete aktivitet figuren me te mire e beri çiklisti tanime i mirenjohur Besnik Musai.

Prill 2000

- Ne datat 07-08 Prill ne Malte Presidenti i KOKSH-it z. A. Jorgoni morri pjese ne Seminarin e organizuar nga CIO mbi problemet e zhvillimit te Lojrave Olimpikete te Sidney 2000.

- Ne datat 12-15 Prill Presidenti i KOKSH-it z. A. Jorgoni pati nje takim pune me homologet Maqedonas. Gjate vizites Presidenti shoqerohej nga z. Mustafa Tukseferi Kryetar i Komisionit Teknik te KOKSH-it.

- KOKSH ne bashkepunim me QK Femijeve Dures organizuan me 25 Prill Seminarin kombetar per Lojrat Popullore

- Federata Shqiptare e Mundjes zhvilloi Kupen e Republikes per te rritur te rrinj dhe para te rrinj. Po kjo federate ka zhvilluar ne fund te ketij muaji turneun nderkombetar te Bullgarise per te rrinj.

- Federata Shqiptare e Peshengritjes ka marre pjese ne Kampionatin Europian nga data 22-30 Prill. Ne kete aktivitet peshengritesi yne I. Suli i cili konkuroi ne peshen deri 77 kg arriti te ngreje ne dygaresh 360 kg duke fituar vendin e dyte dhe medaljen e argjente.

- Federata Shqiptare e Gjimmastikes ka zhvilluar me 27 Prill Kampionatin Kombetar te Gjimmastikes per para te rrinj dhe te rrinj. Po kjo federate ka zhvilluar me 25-28 prill Turneun Internacional te Gjimmastikes ritmike ne France.

- Federata Shqiptare e Basketbollit ka zhvilluar ne javen e pare te muajit prill Turneun e minibasketit, si dhe me 30 prill-01 maj turneun e me te mireve per para te rrinj.

Maj 2000

- Me date 04 Maj u mblodh Komisioni Teknik i KOKSH-it i cili diskutoi rreth kandidateve te mundeshem per pjesmarrje ne Lojrat Olimpik te Sidney 2000.

-Gjithashtu ne kete mbledhje u diskutua rreth kandidaturave per sportistet e rrinj te cilet do te marrin pjese ne kampingun rinor qe do te organizohet gjate zhvillimit te ketyre lojrave.

- Presidenti i KOKSH-it z. Arben Jorgoni morri pjese ne nje tavoline te rumbullaket me teme Paqja dhe Sporti e cila u zhvillua ne Rome nga data 12-15 Maj.

- Gjithashtu Presidenti Jorgoni morri pjese ne Asamblene e Pergjitheshme te CIO-s e cila u zhvillua ne Brazil nga 21-28 Maj.

- Federata Shqiptare e Gjymnastikes ka marre pjese ne 11-14 Maj ne Kampionatin European te Gjymnastikes Artistike per femra ne Paris.

- Gjithashtu po kjo federate ka zhvilluar ne 20 maj Kampionatin e Aerobise dhe ne 25-28 maj sekretari i saj z. Bardhyl Hoxha morri pjese ne seminarin nderkombetar te Prages.

- Federata Shqiptare e Basketbollit perfundoi kampionatet e te rrinjve dhe te rejave dhe eshte ne fazen finale te Kampionatit Kombetar per te rritur dhe te rritura.

- Federata Shqiptare e Peshengritjes zhvilloi me 23 maj

Kupen e Republikes per te Rrinj ne Peqin.

- Federata Shqiptare e Çiklizmit organizoi me 21-23 maj fazen e pare te Kupes se Republikes.

Qershor 2000

- Presidenti i Komitetit Olimpik z. Arben Jorgoni mori pjese ne seminarin nderkombetar mbi Edukimin Olimpik qe u zhvillua ne Greqi me 02-03. Qershor.

- Komiteti Olimpik Kombetar Shqiptar ne bashkepunim me Unionin Italian te Sportit per te gjithë organizoi ne datat 03-04 Qershor 2000 ne Vlore dhe Tirane ditën nderkombetare te vrapimit per paqen "Viviçita"

- Me date 19 Qershor 2000 u zhvillua mbledhja e Komitetit Ekzekutiv te KOKSH-it si dhe u inaguruan zyrtar e reja te KOKSH-it.

- Presidenti i KOKSH-it Arben Jorgoni pati nje takim pune ne qytetin e Korçes me grupin e peshengritesve (trainiere dhe sportiste) te cilet jane kandidate per ne Lojrat Olimpik te Sidneit.

- Me date 23 Qershor u mblodh KAS i cili morri ne shqyrtim kerkesat e Klubit Shumesportesh "Partizani" dhe Klubit te Futbollit "Kastrioti".

- Me date 23 Qershor u zhvillua ne disa qytete te vendit Dita Olimpik e Vrapimit

-Federata Shqiptare e Basketbollit Zhvilloi me 01.Qershor Maratonen e Minibasketit.

- Federata Shqiptare e Atletikes perfundoi Kampionatin Kombetar ne datat 13-14 qershor.

Nga data 26 Qershor deri ne 02 Korrik Shoqata e Dancit Sportiv Shqiptar mori pjese ne disa gara nderkombetare ne Budua te Malit te Zi.

Korrik 2000

- Me date 26 – 27 Korrik Shoqata e Aeronautikes zhvilloi ne zonen e Llogarase Mitingun Internacional Albania 2000. Per organizimin e kesaj veprimtarie nje ndihmese te madhe dha edhe Bashkia e qytetit te Vlores si dhe forcat e rendit.

- Federata Shqiptare e Boksit me date 27 Korrik organizoi ne qytetin e Fierit Kampionatin Kombetar per te rrinj. Ne kete aktivitet morren pjese te gjithe klubet sportive qe e ushtrojne kete sport bureror si klubet shteterore Partizani, Dinamo, Apolloni, Vllaznia, Tomori, Flamurtari, Skenderbeu, Shkolla e Mjeshterise Durres, Teuta, ashtu edhe ato private si Vezhguesi, Albanet etj. Gjate ketyre ndeshjeve ra ne sy puna e mire qe behet me keto mosha si dhe perspektiva e ketij sporti.

Gusht 2000

- Me date 28 Gusht u zhvillua mbledhja e Komitetit Ekzekutiv te KOKSH-it. Ne kete mbledhje u diskutua rreth delegacionit perfundimtar i cili do te perfaqesoje vendin tone ne Lojrat Olimpike te Sidney 2000.

- Federata Shqiptare e Atletikes nga data 06-07 Gusht morri pjese me nje delegacion te perbere nga atletet Shala, Luli, Maka dhe Ciko

ne mitingun Nderkombetar te Bukureshtit i cili ishte testi i fundit per kualifikim per ne Sidney.

- Federata Shqiptare e Peshengritjes morri pjese nga data 25-27 Gusht ne Kampionatin European te moshes deri 16 vjeç i cili u zhvillua ne Sllovaki. Ne kete aktivitet peshengritesi yne Hamdi Tufa u rendit ne vendin e pare duke fituar edhe medaljen e Arte.

Shtator 2000

- Me 02 Shtator ne ambientet e Tirana International Hotel u zhvillua Gala Olimpike. Ne te u be prezantimi zyrtar i delegacionit te KOKSH-it i cili do te marre pjese ne Lojrat Olimpike te Sidney 2000.

- Me date 05 Shtator u be nisja e delegacionit tone Olimpik per te marre pjese ne keto lojra.

- Me date 12 Shtator u nis per te marre pjese ne lojrat Olimpike te Sidney 2000 Presidenti i KOKSH-it z. A. Jorgoni. - Gjithashtu bashke me z. Jorgoni u nisen per te marre pjese ne kampingun rinor edhe gjimnastja Klesta Meta dhe Atletja e hedhjes se çekiçit Arlisa Alia.

- Me 23 Shtator perfundoi konkurimi i sportistev tane ne Lojrat Olimpike te Sidney 2000. Ne kete aktivitet sportistet tane dhane keto rezultate teknike:

- I.Suli ne peshen deri 77 kg ngriti 355 kg dhe ne perfundim te gares u rendit ne vendin e 5-te nga 18 pjesmarres.

- D. Mata ne ushtrimin e pistoletes grumbulloi 579 dhe u rendit e 11-ta nga 32 konkurente.
- Oltion Luli ne garen e 100 m dha rezultatin 11.08 sek. Duke u renditur i teti nga nente pjesmarresit e baterise.
- Klodiana Shala konkuroi ne garen e 400m dhe ne perfundim te gares ajo u rendit ne vendin e shtate nga shtate pjesmarrese.

Tetor 2000

- Me date 07 Tetor beri nje vizite ne zyrat e KOKSH-it Ambasadori i Republikes se Greqise ne Tirane z.Aleksandros Millias. Ne kete takim ai u prit nga Presidenti i KOKSH-it z. Arben Jorgoni, Sekretari i Pergjithshem z. Stavri Bello si dhe disa pjesmarres ne Lojrat Olimpike.Ne diskutime e tyre theksi u vu n ngritjen e nje qndre te Paqes olimpike si dhe fillimi I pergatitjeve te sportisteve shqiptare per ne Lojrat Olimpike te Atjines 2004.
- Federata Shqiptare e Mundjes zhvilloi me 2-3 Tetor ne Tirane Kampionatin Kombetar te mundjes klasike.Gjithashtu mundesit tane morren pjese me 13-16 tetor ne Kampionatin Ballkanik te mundjes klasike ne Athine ku u morren dy medalje te argjenta dhe tre medalje te bronxta.
- Me ftese te Sekretarit te Pergjithshem te Federates Shqiptare te Mundjes beri nje vizite dy ditore ne vendin tone zv. Presidenti i FILA-s Theodoros Hanakos
- Federata Shqiptare e Volejbollit ne datat 05-07 tetor perfundoi

Kupen e FSHV per femra. Fituese e saj u shpall Dinamo.

- Atletike Nga data 26-29 tetor Presidenti i FSHAz. Flobenc Dilaveri dhe Sekretari i Pergjithshem i Federates z. Ajet Toska morren pjese ne Konferencen e IAAF-it e cila u zhvillua ne Goteborg. Ne kete konference u percaktuan te gjitha detajet ne lidhje me aktivitetet e vitit 2001.

- Shah U nis me 28 tetor per te marre pjese ne Olimpiaden Boterore Ekipi Kombetar.

- Ping-Pong. Me 30 tetor u zhvillua ne Pogradec kampionati Kombetar i ping-pongut per te rrinj

- Me 31 Tetor u zhvillua Asambleja e Pergjitheshme e FSHM. Ne fund te punimeve asambleja zgjodhi per President te F.SH.M z. Besim Kuka ndersa Sekretar u zgjodh V. Bezhani

Nentor 2000

- Me date 02.11.2000. u mblodh Komiteti Ekzekutiv i KOKSH-it. i cili diskutoi rreth pjesmarrjes se delegacionit shqiptar ne Lojrat Olimpike te Sidney 2000 si dhe per tre aktivitetet e ardheshme te Akademise Olimpik, Simpoziumit te pare Kombetar mbi Edukimin Olimpik dhe Projektin rreth Kualifikimit te Administratoreve te Sportit. Gjithashtu ne kete mbledhje u vendos qe ne gjysmen e Nentorit te mblidhet Komiteti Ekzekutiv per te shqyrtuar kandidaturat, dhe ne mesin e muajit Dhjetor te zhvillohet Asambleja e

Pergjitheshme Zgjedhore e KOKSH-it.

- Me date 21.11.2000 u mblodh Komiteti Ekzekutiv. Ne kete mbledhje u percaktua menyra e kandidimit me nga tre kandidate per çdo Federate si dhe menyra e plotesimit te formulareve. U diskutua problemi i bashkepunimit me Qeverine (Ministrine e Turizmit) rreth permiresimit te infrastruktures pasi ne Lojrat e ardheshme Olimpike qe do te zhvillohen ne Athine mundet qe shume ekipe te kryejne stervitje per aklimatizimin e tyre.

- Me date 22.11.2000 u mblodh Komisioni i Arbitrazhit te Sportit i cili morri ne shqyrtim kerkesen e z. Flamur Reci per mosnjohjen e rezultateve te Asamblese Zgjedhore te Federates Shqiptare te Mundjes. Komisioni pasi diskutoi rreth problemit vendosi te lere ne fuqi te gjitha vendimet e Asamblese Zgjedhore te Federates Shqiptare te Mundjes.

- Me date 07-08 Nentor me ftese te Federates Shqiptare te Futbollit mbriti per nje vizite zyrtare ne vendin tone Presidenti i FIFA-s z. Blater.

- Ne viziten e tij ai shoqerohej nga z.Mishel Platini. Gjate qendrimit ne Tirane drejtuesit e FIFA-s u priten ne takime te veçanta nga personalitetet me te larta te vendit si Presidenti i Republikes Mejdani, Kryeministri Meta, zv. Kryeministrja Çeço, Ministria Kultures, Rinise dhe Sporteve Uruçi etj. - Gjithashtu gjate qendrimit te tij delegacioni u prit ne nje takim te veçante nga Komiteti Ekzekutiv i F.SH.F. Me

kreret me te larte te futbollit u diskutuan projektet qe ka FIFA ne lidhje me vendin tone.

- Me date 13 Nentor Federata Shqiptare e Basketbollit ne bashkepunim me FIBA-n organizuan ne Tirane Seminarin teoriko-praktik me trainieret e rinj. Ky seminar eshte ne Programin Europa Basket 2000. Ne kete seminar morren pjese 26 trainiere nga mosha 18-35 vjeç. Gjate punimeve te seminarit referuan edhe dy specialiste te huaj respektivisht Mauricio Mondoni Itali dhe Laszo Killik Hungari.

Dhjetor 2000

- Nga data 01-03. 12.2000 zhvilloi punimet ne Tirane Simpoziumi i Pare Kombetar mbi Edukimin Olimpik. Ne kete simpozium morren pjese specialiste te fushes se sportit, perfaqesues nga MASH, MKRS, Akademia e Edukimit Fizik "Vojo Kushi", Inspektore te Drejtorive Arsimore etj. Ne kete Simpozium referuan edhe dy specialiste Gjerman: Prof. Dr. Norbert Muller, dhe Prof. Dr. Robert Marxen. Simpoziumin e nderroje me pjesmarrjen e saj edhe zonja e pare e vendit Lidra Mejdani.

- Me date 06.12.2000 u mblodh Komiteti Ekzekutiv i KOKSH-it. Ne kete mbledhje u seleksionuan te gjitha kandidaturat e ardhura nga federatat.

- Me date 12.12.2000. u mblodh me kerkese te Presidentit Jorgoni Komiteti Ekzekutiv i KOKSH. Ne kete mbledhje u diskutua

rreth kerkeses se Federatave te Atletikes, Futbollit dhe Boksit per te pranuar si te mireqena kandidaturat e propozuara prej tyre, Komiteti Ekzekutiv pasi diskutoi rreth ketij problemi vendosi te pranoje te gjitha kandidaturat e quajtura si te pavlefteshme dhe te gjitha te futen ne kunkurim te lire ne Asamble.

- Me date 15.12.2000 zhvilloj punimet Asambleja e Pergjitheshme Zgjedhore e KOKSH-it. Ne kete asamble u be bilanci i punes 4 vjeçare te ketij institucioni, u miratuan ndryshimet ne Statutin e tij. Ne perfundim te punimeve Asambleje zgjodhi si President te KOKSH-it z. Hysen Domi, si Sekretar i Pergjithshem u rizgjodh z. Stavri Bello.

- Me date 21.12.2000 ne Tirana International Hotel u zhvillua Sesion i Vjetor i Akademise Olimpik. Ne kete Sesion morren pjese anetare te Akademise, Studente te Akademise se Kultures Fizike si dhe te ftuar te tjere. Nderoi me pjesmarrjen e tij Dekani i Akademise Olimpik Nderkombetare Kosta Georgiadis. Gjithashtu ne kete Sesion morren pjese edhe perfaqesues nga Komiteti Olimpik i Kosoves dhe Dekani i Fakultetit te Edukimit Fizik dhe Sportit te Universitetit te Tetoves.

- Me date 22-23.12.2000 ne ambientet e Akademise se Kultures Fizike "Vojo Kushi" u zhvillua Seminari mbi Mjekesine Sportive. Ne kete Seminar morren pjese mjeke sportive nga te gjitha

klubet e vendit, Akademise se Kultures Fizike "Vojo Kushi", te Qendres Kerkimore Shkencore te Sportit si dhe te ftuar te tjere.

Ne date 05 Dhjetor zhvilloi punimet Asambleja e Pergjitheshme Zgjedhore e Federates Shqiptare te Atletikes. Ne kete Asamble u shqyrtua puna e bere e 4-vjeçarin e kaluar si dhe prespektiva qe e pret atletiken shqiptare ne te ardhmen. Ne fund te punimeve Asambleja zgjodhi per President te F.SH.A. z. Artan Shyti dhe Sekretar z. Ajet Toska.

- Me date 10 Dhjetor u zhvillua ne Athine te Greqise Konferenca Ballkanike e Volejbollit. Federata Shqiptare e Volejbollit u perfaqesua ne kete aktivitet me z. Leonard Tase Sekretar i Pergjithshem dhe z. Gjergj Pishtari inspektor prane kesaj federate. Ne kete Konference u diskutua rreth prespektives se volejbollit Ballkanik.

- Me 15 Dhjetor Federata e Arteve Marciale zhvilloi Asamblene e Pergjitheshme te saj. Ne kete Asamble u rizgjodh si Sekretar z. Fiqiri Guri.

- Po me 15 Dhjetor zhvilloi punimet edhe Asambleja e Zgjedhore e sportit te Alpinizmit. Edhe ne te u rizgjodhen si President z. Janaq Ziso dhe si Sekretar z. Astrit Omeri.